



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit anonim për korrupsion, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-3329 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit 12-3329/1 me datë 27.06.2019 dorëzuar nga parashtrues i panjohur, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komision shtetëror përparandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën me nr. 12-3329 nga viti 2019, në rastin e lëndës me kërkesë të KSHPK veproi organ tjetër kompetent dhe nuk janë vërtetuar akuzat e lëndës.

Lënda me numër 12-3329 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda e numër 12-3329 nga viti 2019 është formuar pas denoncimit nr. 12-3329/1 me datë 27.06.2019, dorëzuar deri në Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtrues i panjohur – denoncim anonim.

Në denoncimin e dorëzuar janë treguar akuza për parregullsi në procedurën për punësim të realizuar në Kuvendin e RMV nëpërmjet konkursit publik të shpallur në periudhën Korri-Gusht të vitit 2018 dhe akuza për dyshime dhe paligjësi dhe gjendja e konfliktit të interesave gjatë punësimit të personit në procedurën e lëndës, dhe i cili punësim është bërë në Sektorin për Njësia për në pozicionin e punës Këshilltarë për kontroll, dhe njëherit shprehë pakënaqësi nga procedura e lëndës dhe dyshime për kryerje të ndikimit gjatë punësimit të një nga kandidatë e zgjedhur në procedurë. Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar edhe dokumentacion në lidhje me akuzat e lëndës.

Gjatë rishkimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri në Inspektorati shtetëror administrativ, në përputhje me kompetencat e veta, të bënë inspektim në lidhje me akuzat e lëndës dhe të dorëzon informacione për masat eventuale të ndërmarra dhe aktivitete në lidhje me gjendjen e konstatuar gjatë inspektimit të bërë. Me kërkesë të KSHPK është dorëzuar lajmërim për inspektimin e bërë dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilin disponon për rastin e lëndës, KSHPK konstatori me sa vion:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza për parregullësi gjatë punësimit të personit nga, i cili ka qënë punësuar në Kuvendin e RMV nëpërmjet konkursit të shpallur, edhe pse personi i njëjtë nuk i plotëson kushtet themelore për punësim të theksuara në konkursin për punësim dhe se gjatë konkurimit nëpërmjet sistemit për aplikim elektronik në web-faqen e Agjensionit për administratë, nuk janë dorëzuar të gjitha dokumentat e

nevojshme; dëshmi për përvojën e duhur në fushën e punës, certifikate për njohje të shkathtësive kompjuterike dhe certifikat ndërkombëtar për njohje të gjuhës së huaj, të cilat i ka kërkuar Agjensioni, dhe prapsepap ka qenë procedurë e përsëritur për selektim dhe personi i përmendur është udhëzuar të bënë provim administrativ, duke mos poseduar certifikatë për njohje të gjuhës së huaj edhe pse për vendin konkret i njëjti kërkohet.

- Njëherit, në denoncimin e dorëzuar tregohet pakënaqësi për procedurën e lëndës për ndikim gjatë punësimit të një nga kandidatët e zgjedhurit në procedurë dhe për ekzistimin e gjedjes së konfliktit të interesave, përshkak se personi i përmendur ka qenë komshiu i Sekretar Gjeneral i Kuvendit të RMV, prandaj ekziston dyshim se ajo ka ndihmuar në punësimin e lëndës, përshkak se vendimi për punësimin e lëndës i cili ka qenë publikuar në web-faqen e Agjensionit për administratë në fillim të muajit Gusht të viti 2018, është nënshkruar nga ana e Sekretar gjeneral në Kuvendin e RMV. Sipas parashtrusit të denoncimit, kjo ka qenë e lidhur me shërbim tjetër i cili paraprakisht është dhënë nga familja e personit të punësuar i cili i ka shitur vend oborri djalit të pronar i ndërmarrje ndërtimi me qëllim që në tokën e njëjtë të ndërton objekt banesor dhe për shërbim të saj t'i jepet një banesë në objekti që do të ndërtohet.
- Me datë 20.08.2020, është marrë përgjigje me të cilën lajmërohet se nga ana e Inspektoratit shtetëror administrativ është vepruar për kërkesën e KSHPK dhe është bërë inspektim i jashtëzakonshëm në Agjensionin për administratë të RMV, në lidhje me procedurën e lëndës për punësim me çka është konstatuar me sa vijon:
- Me përgjigje të kërkesës me datë 31.07.2020, nga ana e Agjensionit për administratë është përshkruar procedura e realizuar për Konkursin publik (...../.....) për punësim të nënpunësve shtetëror për nevojat e Kuvendit të RMV, e nevojshme për vendin e punë së lëndës: këshilltarë për, Njësia për, Skeretar për
- Me datë 19.06.2018 për nevojat e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është shpallur konkurse me nr./..... (në gazetata ditore "Nova Makedonija", "Sloboden pecat" dhe "Koha") për punësim të 19 ekzekutorëve – nënpunës administrativ, në të cilën me numër rendor nr..... është paraparë punësimi i një ekzekutori në vendin e punës të theksuar më lartë.
- Në përputhje me Ligjin për nënpunës administrativ, Drejtori i agjensionit për administratë me Vendim nr..../..... me datë 20.06.2018 formoi komision për selektim për punësim për konkursin publik. Pas realizimit të fazës së parë nga procedura për selektim për punësim të nënpunësit administrativ – selektim administrativ për vendin e punës së përmendur kurse parë nga Procesverbali për selektim administrativ nr/..... me datë 12.07.2018, Komisioni vërtetoi se nga 14 kandidatët e paraqitur, 3 kandidatë ishin në rregull, kurse 11 kandidatë nuk ishin në rregull.
- Në pikëpamje të kandidatit, me kod identifikimi, sipas dokumenteve të ngarkuara në fletëparaqitjen për punësim, nuk ka të dyshimta, gjegjësisht dokumenta të përpunuar pa rregull, dhe fakte të përmbajtuar në to, dhe të cilët do të ndikoheshin në procedurën e rregullt dhe ligjore të Komisionit për selektim. Nga certifikata e historiatit për punësim të kandidatit është vërtetuar se i njëjti ka përvojë pune të evidentuar si stazh pune të së paku 3 vite, pas diplomimit në arsimimin adekuat, gjë në realitet ka qenë edhe kusht i veçantë për vendin e punës konkret.

- Në periudhën e realizimit të procedurës së lëndës nuk kanë ekzistuar dispozita plotësuese ligjore, e as akte nënligjore dhe të veçantë në profesionin (drejtimit) dhe Komisioni për selektim ka vepruar veçanërisht sipas dispozitave të Ligjit për nënpunës administrativ, gjegjësisht për caktimin e përvojës së punës i ka rishikuar të dhënat që gjenden në certifikatën e historiatit për punësim të dhënë nga Agjensioni për punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pa kërkuar sqarime plotësuese dhe shtojca për kushtet për vendin e punës në të cilën kandidati ka marrë përvojën e punës. Gjithashtu, në fletëparaqitje për punë ekzistojnë edhe dëshmi relevante për njohje të programeve kopmjeterike për punë në zyrë të cilën Komisioni për selektim e vërtetoi si në rregull, dhe më tej janë zhvilluar fazat tjera të procedurës.

Në fazëm e dytë nga procedura për punësim – provimi për nënpunës administrativ është realizuar pa kaluar pjesën për njohje të një gjuhe të hauj që flitet më shpesh në Bashkimin Evropian (gjuhë angleze, frenge, gjermane) në përputhje me nenin 26 paragrafi 2 nga Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për nënpunës administrativ (gazeta Zytrate e RM, nr. 11/2018) ku është caktuar se: "Nënpunësit administrative të cilët kanë themeluar marrëdhënje pune nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fillimin e ndryshimit të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, janë të obliguar të kalojnë provimin për nënpunës administrativ me të cilin kontrollohen njohuritë të një nga tre gjuhët që më shpesh flitet në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, frenge, gjermane) në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Për vendin e punës së lëndës në provim kan hyrë 3 kandidatë dhe të gjithë e kan kaluar provimin, gjegjësisht kandidati..... e kaloi provimin për nënpunës administrativ që shihet nga Procesverbali i realizimit të provimit për nënpunës administrativ nr. .../.... me datë 25.07.2018. me lajmërim nr./... me datë 29.10.2018 Agjensioni për administratë e informoi Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut se 8 nënpunës administrativ (në mes të cilëve dhe) të cilët themeluan marrëdhënje pune pas konkursit publik/.... janë në obliguar të hyjn në provim për nënpunës administrativ për njohje të një gjuhe që flitet më së shpeshi në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, frenge, gjermane). Provimi është realizuar me datë 13.12.2018 dhe në të e kaloi provimin, e parë nga Procesverbali nr. me datë 13.12.2018.

Në fazën e tretë – kontrollim i besueshmërisë së dëshmimeve dhe intervju, për vendin e punës të lëndës të ftuar kan qenë të gjithë tre kandidatët të cilët e kaluan provimin, me çka Komisioni për selektim konstatoi se të tre kandidatët kanë dokumentet të besueshme dhe me të gjithë është realizuar intervju gjë që është parë nga Procesverbali i realizimit të kontrollimi të besueshmërisë së dëshmimeve dhe intervju për nënpunës administrativ nr. me datë 30.07.2018. gjatë realizimit të intervjusë Komisioni për selektim nëpërmjet pyetjeve gojore i ka vlerësuar njohuritë e përgjithshme të kandidatëve. Kompetenca të përgjithshme dhe të veçanta si dhe njohje të gjuhës maqedone.

- Pas realizimit të intervjusë, si fazë e fundit e procedurës, Komisioni për selektim ka përgaditur rang listë përfundimtare sipas të cilës është përgaditur propozim për punësim të kandidatit të ranguar më mirë në bazë të cilës është bërë zgjedhje e kandidatit për punësim si nënpunës administrativ me vendim për zgjedhje nr./.... me datë 01.08.2018, është

- marrë nga ana e Kuvendit të RMV, e cila ka qenë publikuar në faqen e internetit të Agjencionit për administratë dhe kundër të njëjtë nuk ka pasur ankesa të dorëzuara.
- Në bazë të gjendjes së mësipër kronologjike, Agjencioni për administratë në përgjigjen e vet deri në inspektoratin kompetent potencohet se procedura e selektimit të kandidatëve për punësim të nënpunësve administrativ ka qenë e udhëhequr në rregull në përputhje me dispozitat e Ligjit për nënpunës administrativ, duke respektuar parimin e profesionalizmit dhe kompetentë në transparencë, fer dhe procedurë konkurente për zgjedhje të kandidatit më profesional dhe më kompetent për vendin e punës dhe u rrefuzuan të gjitha akuzat (të dorëzuara në denoncimin deri në KSHPK) për ekzistimë e çfarëdo ndikimi dhe veprimi jologjior gjatë realizimit të procedurës së përmendur gjatë punësimit.
 - Në bazë të gjendjes faktike të caktuar, nga ana Inspektoratit shtetëror administrativ nuk janë vërtetuar parregullësi në punën e subjektit për mbikqyrje, për shak të së cilës në përputhje me nenit 83 paragrafi 5 nga Ligji për inspektim, procedura për inspektik ka qenë ndërprerë.

Në bazë të të gjithë të konstatuarës mësipër, KSHPK vërtetoi për rastin e lëndës, pas kërkesës së KSHPK është vepruar nga ana e organit kompetent – Inspektorati shtetëror administrativ i cili ka bërë inspektim të jashëtzakonshëm në lidhje me procedurën e lëndës për punësim me çka nga ana e inspektoratit kompetent nuk janë vërtetuar parregullsi në punën e subjektit për mbykqyrje, përshkak të së cilës në përputhje me nenin 83 paragrafi 5 nga Ligji për inspektim të procedurës pas inspektimit është ndërprerë, me çka nuk janë vërtetuar akuzat e lëndës për parregullësi në procedurën e lëndës për punësim. Duke pasë parasyshë gjendjen faktike të caktuar, Komisioni shtetëror vlerësoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për këtë rast të lëndës, procedura për lëndën ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dipozitë të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 14 Dhjetor të viti 2020, me numër 12-2487/3

Dorëzuar deri te: arkiva
Pas përfundimit të KSHPK
Punoi: J. C., këshilltarë
Miratoi: m-r B. G., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**
Kyetar: Biljana Ivanovska